OSSH
OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES
OSHEE GROUP

# PROJEKT IDE

“Ndertimi i 2 Fiderave te rinj T15 dhe T 20 nga N/St. I ri i Kombinatit per uljen e ngarkesave te fiderave T 14 me fid. 355 dhe fid. T13 me F13”

## 1. INFORMACION I PERGJITHSHËM

Kjo projekt ide parashikon ndertimin e dy fiderave te rinj, te cilet do te dalin nga nga N/Stacioni I ri I Kombinatit, dhe do te lidhen respektivisht ne lidhjet unazore te fiderave T13 me F 13 dhe Fiderave T 14 me fid 355, gjithashtu do te behet edhe rikonstruksioni nga ana elektrike i disa kabinave te ketyre fiderave. Pika e lidhjes do te jete ne nje kabine e cila do te sherbeje si pike Lidhje unazore. Dy kabinat te cilat do te bejne ndryshimin e unazave ekzistuese per uljen e ngarkesave ne pikun e tyre, do te rikonstrukstohen si nga ana elektrike edhe ajo ndertimore si dhe do te shtohet nga nje cele e re linje.

**HYRJE**

Rajoni i Tiranës është ndër rajonet më të mëdha të Shqipërisë. Qyteti Tiranës dhe zonat periferike të saj karakterizohen nga një zhvillim intensiv i gjithanshëm, vecanerisht i ndertimeve ne kete zone. Keta faktore kane bere qe ritmet e rritjes se kerkeses per energji elektrike te jene mjaft te larta.
Projekti përmban linjat e tensionit të mesëm 20 kV, ndertimin e dy fiderave te rinj, te cilet do te dalin nga nga N/St. I ri I Kombinatit, do te kalojne ne krah te rreth rrotullimit te ri te Yzberishtit, dhe te vijone pergjate bulevardit te ri Migjeni ne Astir ( ne trotuar ). Keto 2 fidera do te jene te futur ne tuba PVC me parete te trasha si dhe do te llogariten qe te shtrihen edhe dy tuba te tjere rezerve ne te njejtin kanal. Kabinat ku do te realizohen pika e lidhjes, do te jene respektivisht ne kabinat K 19 te Fid. 355, dhe kabina K17 e Fid. T13.

Zona qe perfshihet nga projekti furnizohet nga:

| N/ Stacioni | Fideri | Ngarkesa ( A) |
|---|---|---|
| Kombinat | Fid. T13 | 225 |
| Kashar | Fid. F 13 | 200 |
| Selite | Fid. 335 | 195 |

SKEMA PRINCIPALE E FIDERIT T 13 N/STACIONI KOMBINAT



## SKEMA PRINCIPALE E FIDERIT  F 13   N/STACIONI KASHAR




## SKEMA PRINCIPALE E FIDERIT  F 335   N/STACIONI SELITE



**OBJEKTI I RELACIONIT TEKNIK**

Rrjeti i Ri 20 kV, ndertimi I dy fiderave te rinj qe do te dalin nga N/Stacioni I Ri I Kombinatit do te jene me kabllo me izolacion XLPE Al 3 x (1 x 240) $mm^2$.

Gjatesia totale e shtrirjes se 2 fiderave te rinj do te jete afersisht 5.5 km.



Traseja e fiderave te rinj TM

Gjatesia e linjave TM, kabinave dhe LTU te parashikuara per mbulimin e ketyre fshatrave do te jete afersisht:

| Te dhenat e rrjetit , projekt paraprak | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Nenstacion,Fider, Kabine,Dalje TU** | **Fider** | **Linje TM** | | | | **Kabina** | | | **Linja TU** | | | **Matje** | **Nr. Abontеve** | **Fuqia max.** |
| | | | **Kabllore** | | **Ajrore** | | **Muratur** | **Ajrore** | **Box** | **ABC** | **Kabell XLPE** | **Percjelles zhveshur** | | | |
| | | | **km** | **Sek** | **km** | **Sek.** | **cope** | | | **km** | | | **Sasi** | | **P=kVA** |
| | Kombinat | T-x | 2.5 | 240 | | | 0 | 0 | | | | | | | |
| | Kombinat | T-y | 3 | 240 | | | | | | | | | | | |

Ky projekt është i nevojshëm pasi lidhjet unazore aktuale qe furnizojne zonen e Astirit , nje zone e cila vijon te mbetet ne zonat ku investimet jane ne hovin e tyre maksimal , jane tejet te ngarkuara dhe nuk garantojne furnizimin me cilesi te abonenteve. Per kete arsye parashikohen te ndertohen dy fidera te rinj te cilet do te krijojne lidhje unazore te reja me qellim uljen e ngarkesave ne kete zone. Te dy fiderat e rinj T qe do te dalin nga N/Stacioni I kombiantit do te kene respektivisht gjatesi te njejta, pasi do te shtrihen ne te njejten trase .

**KONKLUZIONE**

Gjatesia e linjes TM per Fiderin T-15 N/Stacioni Kombinat qe do te lidhet ne kabinen K19 Fid 335 N/stacioni selite do te jete afersisht 2.5 km i gjate.

Gjatesia e linjes TM per Fiderin T-20 N/Stacioni Kombinat qe do te lidhet ne kabinen K17 Fid T13 N/stacioni Kombinat do te jete afersisht 3 km i gjate.

*Po te bejme analizen tekniko ekonomike verejme se :*

- Zgjidhja teknike me e mire
- Furnizimi sipas standarteve
- Siguri me te larte
- Rritje kapacitetesh
- Krijim rezerva kapacitetesh per perballuar zhvillimin ne perspektive te zones
- Uljen e humbjeve teknike

Kostoja e perllogaritur sipas projekt idese per zbatimin e ketij projekti do te jete afersisht 8**0,000,000 Lekë**.